



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 22/18
Prishtinë, më 11.4.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Jelena Bontic, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Enver Hoti, Dardan Molliqaj.

Munguan: Blerim Kuçi dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Hilmi Jashari – Avokati i Popullit, Jashar Kastrati – Sekretar i Përgjithshëm në Insitucionin e Avoktatit të Popullit, Beqir Musliu – Zyrat Kryesorë Financiar nga Institucioni i Avoktatit të Popullit, Shaip Havolli – Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Bedri Mecini – Zyrtar Kryesorë Financiar nga AKK, Dafina Hasan-Meta – ZBF nga AKK, Arsim Janova- UD Kryeshef në ZRRE, Selmani Hoti – Antarë i Bordit të ZRRE-së, Izet Rushiti- Antarë në ZRRE, Besim Zejfiqaj– Anëtar i Bordit të ZRRE-së, Petrit Pepaj – Drejtor Menaxhures në ZRRE, Ejup Hasolli – Zyrtar Kryesor Financiar nga ZRRE.

Pjesmarresit tjerë: Albulena Avdiu- Gazetare nga Ekonomia Sot, Amire Qamili- Gazetare nga Birn.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 28 dhe 30 mars 2018;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Institucionit të Avoktatit të Popullit për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit vitin 2017;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2017;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 28 dhe 30 mars 2018

Kryetari – konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 28 dhe 30 mars 2018, miratohen njëzëri, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017

Hilmi Jashari - raportin e kemi dergu me kohë në Kuvend. Buxheti i institucionit të avokati të popullit ka qenë 1,836 milion euro dhe të gjitha janë shpenzuar në pajtim me planin strategjik. Për shkak të vonesave në përzgjedhjen e zv.avokatëve të popullit, ka rezultuar me nivelin e kursimit të cilat janë pasqyruar në këtë pjesë të raportit. Po ashtu edhe tek shpenzimet kapitale kemi deklaruar kursime 51,000 euro, ndërsa buxheti në total është shpenzuar 80.66%.

Kryetari –shpenzimet e qerasë i keni deklarura 44,000 euro, a keni bërë kërkesë për vendosjes në ndonjë institucion publik?

Hilim Jashari – theksoi se në vitin 2017, nuk kanë pasur pagesë të qerasë. Jemi të vendosur në objekt shtetëror.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se po më vjen mirë që tani avokati i popullit nuk ankohet për buxhet, pasi që ish avokati, edhe përkundër përpjekjeve të komisionit me ndihmë, gjithnjë është ankuar për buxhet. E kam shikuar raportin, dhe sa i përket numrit të të punësuarve, e kam të qartë se procesi i zgjedhjes së pesë zëvendës-avokatëve të popullit është ndikuar për shkak se Kuvendi ka qenë në zgjedhje, ndërsa tani pas zgjedhjes së problemit të objektit është mirë me i punësuar edhe punëtorët tjerë të planifikuar. Nga materiali që kam parë, shifet se nuk keni bërë tejkalime të shpenzimeve nga ajo që është planifikuar. Nuk kam diçka me ngrit si çështje të veçantë, dhe ju deshirojmë punë të mbarë dhe ne jemi këtu për t'iu mbështetur kur keni nevojë.

Hilmi Jashari – si rezultat i anulimit të katalogimit për paga nga Gjykata Kushtetuese, ne është dashtë të merremi mbi gjashtë muaj me ministrinë e financave dhe ministrinë e administratës publike për këtë çështje. Po ashtu është me rëndësi të ceket se Avokati i Popullit gjatë vitit 2017, ka pasur të arritura në realizimin e projekteve dhe planit të përcaktuar.

Kryetari - ju falënderoj për raportim korrekt. Në raportet tjera, ju lutem që buxheti të kërkohet në përputhje me nevojat dhe planifikimet, pasi që në disa kategori keni shpenzuar 50%. Një këshill tjetër ka të bëjë me drekat zyrtare që të shikoni mundësinë e reduktimit sepse janë të larta, pra në shumë prej 18,000 euro, edhe krahasuar me institucionet tjera.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit vitin 2017.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit vitin 2017

Kryetari – në bazë të nenit 5, paragrafi 1.16, dhe nenit 12 të Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Agjencia i raporton Kuvendit një herë në vit.

Shaip Havolli – theksoi se buxheti i Agjencisë fillimisht ka qenë 505,664 euro, pas ndryshimeve me rishikim, buxheti përfundimtar ka qenë 480,703.68 euro. Sipas kërkesës së Ministrisë së Financave, për mjetet rezervë që kemi pasur, ne kemi kthyer 25,000 euro. Buxheti në total është shpenzuar 92 % të buxheti të aprovuar, për paga dhe mëditje 100%, mallra e shërbime 68,65%. Sa i përket shpenzimeve komunale, shumicën e tyre i mbulon ministria e administratës publike. Nuk kemi investime kapitale. Ne kemi përfituar nga një projekt i UNDP-së që na ka sjell nje serverë prej 22,000 euro për dizajnimin e web faqës. Po ashtu nga Eulex-i kemi marr një donacion prej 8,800 euro. Mbështetje kemi edhe nga Zyra e BE-së, nga një organizatë e huaj SAIK, që po na ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve tona.

Kryetari - kam një kërkesë që herën tjetër të bashkangjitni organogramin. Ju jeni duke parë që komisioni është duke ba shkurtime, ju lutem tp na shpjegoni çka janë shtesat për punëtorë për rrezikshmëri?

Shaip Havolli – sqaroi se shtesa për rrezikshmëri është marrë që më herët dhe atë e marrin zyrtarët që merre drejtëpërdrejtë me zbatimin e ligjit dhe punojnë me raporte dhe informata konfidenciale.

Bedri Mecini – sqaroi se shtesa për rrezikshmëri është në bazë të vendimit të Qeverisë dhe vlera e saj është 107 euro për person.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se Qeveria ka miratuar shtesën për rrezikshmëri, por kjo çështje ka kaluar edhe në komision dhe jemi pajtuar me këtë shumë simbolike. Agjencia është korrekt në raportime dhe nuk bënë shpenzime jashtë planifikimeve. Një çështje që më intereson është sigurimi i ndërtesës në shumë prej 7,000 euro?

Shaip Havolli – theksoi se natyra e punës së agjencisë, kemi dy llojë sigurimesh. Përveç sigurisë që bënë policia angazhojmë edhe një sigurim privat. Më herët kemi pase disa sulme të punëtorëve e institucionit gjatë deklaramit të pasurisë, ku zyrtarët vijnë dhe sillen në mënyrë arrogante pse po na detyroni me i paraqit pasurinë.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se për ligjin ju nuk jeni fajtor se ne e kemi miratuar, unë jam idhëtare e asaj që të dhënat me qenë të qasshme dhe në dispozicion për Agjencinë kundër korrupsionit, por edhe Agjencia duhet me bë hulumtimin dhe verifikimin e pasurisë, dhe mos të jenë e publikuar, çdo gjë në web faqe.

Shaip Havolli – theksoi se është e vërtetë që deklarimi i pasurisë në web faqes i shkakton telashe të gjithëve, edhe zyrtarëve të lartë. Me draftligjin e ri jemi duke diskutuar mundësinë që parat e deponuara apo të gatshme të mos të jenë të qasme për publikun, por vetëm për agjencin.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit vitin 2017.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2017

Kryetari - ZRRE ka dërguar raportin brenda afatit ligjor, për më tepër kërkojë nga përfaqësit e ZRRE-për prezantimin e raportit.

Arsim Janova – buxheti i ZRRE-së për vitin 2017, fillimisht ka qenë 768,316 euro. Me vendimin e qeverisë është shkurtuar prej 83,800 euro dhe buxheti final ka qenë 684,516 euro. Realizimi i buxhetit është 592,128.02 euro apo 86.50%. Sa i përket të hyrave, prej taskave nga licencat, janë mbledhur 1,412,853.40 euro. Meqenë se buxheti i ZRRE-së ka qenë 592,128 euro, teprica e të hyrave është derdhur në buxhetin e Kosovës në pajtim me ligjin. Mosrealizimi i kënaqshëm i buxhetit, përfshirë pagat, është ndikuar edhe nga mungesa e tre anëtarëve të bordit. Mungesa e bordit ka pamundësuar edhe rekrutimin e një vendi të punës sepse vetëm bordi është dashur të vendos për pranimin e punëtorit. Arsyeje tjetër që ka ndikuar në realizimin e buxhetit është edhe Agjencia Qendrore e Prokurimi, kur për disa furnizime për ZRRE-në, ka pasur përseritje të procedurave. Kemi pasur edhe disa konsulenca nga USAID-i.

Kryetari - në formularin në pjesën e fundit, që flitet për punëtor, ka një paqartësi të pozitive e të aprovuara 33, ndërsa tek realizimi ju keni vendosur dy shifra 29 dhe 31?

Ejup Hasolli – sqaroi se numri i punëtorëve ka qenë 31 në fillim të janarit, por ne ndërkohë i ka skaduar kontrata njërit dhe kemi mbetur një më pak. Por edhe më vonë ka qenë edhe një anëtar që ka dhënë dorëheqje, dhe prandaj është shkruar 29 dhe 31.

Kryetari – kërkojë që herave tjera raportit me ia bashkangjitur organogramin sepse kështu e kërkon formulari. Çështja e dytë keni shpenzuar për qira 55,000 euro që është mjaftë e lartë, a keni bërë kërkesë në institucionet publike me u vendos në një objekt shtetëror?

Arsim Janova – theksoi se ne kemi bërë disa kërkesa ministrisë së administratës publike për sigurimin e një objekti, por çdo herë kemi marr përgjigje negative se nuk ka hapësira publike.

Naser Osmani – të thënë të drejtën kjo që bëjmë është mënyra më e thjeshtë e shqyrtimit të raportit. Meqenëse këta janë institucion i cili krijon të hyra dhe kjo ishte dashtë me qenë pjesë e raportit dhe gjithë aktivitetet që kanë ndodhur në këtë insitucion, që ka të bëjë edhe me blerjen e rrymës, shitje, etj. Do të ishin më interes për ne me ditë edhe për burimet e energjise, ku i blejnë, sa i kemi të shprehura në mjete monetare dhe po ndodhë me energjinë alternative, për rolin e saj në raport me KEDS-in, çfarë po ndodhë me sistemin e energjisë dhe këto informata të jenë për raportim.

Enver Hoti - theksoi se të hyrat janë realizuar aq sa janë planifikuar, por duhet me pas një listë për të parë se si janë realizuar ato. Sa i përket udhëttimeve jashtë vendit, janë realizuar më pak, ndërsa mëditjet ekzaktë, siç janë planifikuar. Një sqarim për këtë?

Arsim Janova – sa i përket shpenzimeve për udhëtimet zyrtare jashtë vendit, ne si Zyre kemi anëtarët tonë në grupet punuese për energji, gaz në kuadër të sekretariatit të energjisë, dhe një pjesë të shpenzimeve të udhëtimit i mbulon sekretariati, ndërsa mëditjet i marrin nga Rregullatori, për arsye janë më të mëdha mëditjet se sa shpenzimet jashtë vendit. Në raportin e punës, ne kemi paraqitur të gjitha aktivitetet në detale, përfshirë edhe të hyrat nga taksat e licencuarve, dhe çështjet që u ngriten nga deputeti Osmani.

Kryetari – më intereson të dijë për rolin tuaj në çështjen e pagesës së rrymës në veri. Arsyeja pse po e ngriti këtë çështje është se neve na ka ardhur kërkesa e shpenzimeve të rezervës buxhetore se duhet me i

nda nga 1 milion euro për atë pjesë të veriut. Për këtë kemi diskutuar edhe me Kostt-in dhe Ministrin e Financave, pyetja ime është sa jeni të përfshirë në çështjen e Kostt-it në furnizimin me rrymë në veri?

Dardan Molliqaj – shpenzimet e telefonit janë 11,126 euro. Ju keni 33 të punësuar, pse kaq shumë mjete për shpenzime telefonike?

Arsim Janova – sqaroi se deri këtë vjet e kam pas një kontratë me Ipkon për telefon. Anëtarët e bordit i kanë 40 euro mbushje të lejuara, ndërsa stafi 30 euro. Tani e kemi kontratën me Valen me të njëjtat kushte.

Dardan Molliqaj – cila është arsyeshmëria që të gjithë njerëzit që punojnë në ZRRE me pas shpenzime të telefonit?

Arsmi Janova – theksoi se më shumë janë staf profesional të cilat kanë komunikim me të licencuarit dhe është miratuar kjo shumë.

Dardan Molliqaj – po ju sugjeroj me e rishikue këtë vendim dhe mendoj se është e panevojshme dhe e padrejtë kjo shumë për shpenzime telefonike. Menagjimi më i mirë do të kursente dikun 10,000 mi euro.

Kryetari - ju e keni parë se ne kemi nis edhe nëpër institucione tjera shkurtime e shtesave. Ju nuk keni shtesa tjera, por ne shumë institucione po shohim se ka disa defekte. Por, shpenzimet për dreka zyrtare dhe telefon janë shumë të mëdha dhe ju sugjerojmë të planifikoni me pak në këto kategori, që me i destinue mjetet dikun tjetër. Shpenzimet e telefonisë mobile, të shikoni mundësinë e kursimeve. Por edhe në udhëtimet zyrtare duhet shikuar mundësia e kursimit dhe kjo do të ndikonte që edhe raporti me dal më mirë.

Dardan Molliqaj - kisha pas një sugjerim se duhet me i rritë planifikimet e shpenzimeve ku është e nevojshme, siç janë trajnimet e stafit që kanë nevojë për avansime. Kështu që menaxhim më i mirë do të ishte që me i kursy mjetet e shpenzimeve telefonike dhe me i vendos tek trajnimet për staf.

Enver Hoti - nga raporti i Kostt-it, janë vlerësuar disa rreziqe dhe ndër tjera është evidentuar problemi i mosfunksionimit të linjës së energjisë Kosovë-Shqipëri, që është një shqetësim për ne sepse aty thuhet se kjo linjë është ngritur me kreditime, e kredia ja ka fillu me rrjedhë dhe ajo fillon të kostohe në fakturat e qytetarëve, pyetja ime është cili është vlerësimi i juaj dhe cilat janë masa parandaluese që do ti ndërmerri ju si ZRRE?

Dardan Molliqaj – pyeti a mundeni me i nda shumat totale për pagat dhe meditet, që me e ditë se sa është shuma për paga dhe sa janë shpenzimet e mëditjeve?

Safete Hadërgjonaj - nga tabelat e fundit po e shoh se janë planifikuar për pagat dhe mëditjet për bordin në shumë prej 124.740 euro, dhe po shifet se është shpenzuar më pak, dhe 26% e mjeteve janë të parapara për pagat e bordit, që konsiderojë që është një planifikim dhe shifër e lartë. Kur e shikojm raportin për mëditje për udhëtime zyrtare (pa shpenzimet tjera), janë shpenzuar rreth 15,000 euro që janë të larta, dhe duhet me marr një hap pozitivë në këtë drejtim edhe qeveria për me e ndryshu rregulloren për pagesen e mëditjeve jashtë vendit. Tek faqja 92 e raportit, po e shoh një kategori “importi për konsumatorë të shërbimit univerzal për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, dmth, importi nga Kesko për mbulimin e humbjeve në shpërndajre është 18 milion e 532 mijë e 83 euro, a mundesh me na shpjegu këtë vlerë? Si dhe me na shpejgue çfarë është importi me Kesko për tregtim me Kostt. Meqenëse Kostt-i i raporton Kuvendit, më intereson të dijë si e caktoni ju tarifën e buxhetit

të Kostt-it? Po ashtu është me interes me ditë, humbje komerciale të energjisë a janë rritur apo zvogëluar në vitin 2017?

Arsim Janova – sa i përket udhetimeve jashtë vendi, ZRRE për shkak të aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në shumë takime me rregullatorët e energjisë që janë katër herë në vit, konferenca e seminare që merr pjesë stafi. Në shumicën e takimeve, shpenzimet e udhëtimit i heq organizatori, ndërsa mëditjet merren nga ZRRE.

Petrit Pepaj - lidhur me linjën 400 kw, kthimi i investimit përmes tarifave nga konsumatori nuk mundet me u bë perderisa ata nuk i shfrytëzojnë benefitet e saj apo nuk funksionalizohet linja. Te çështja e importit të energjisë elektrike, prej 1 prillit është bërë liberalizimi i tregut dhe furnizuesi ka obligim me mbulue kërkesën që nuk mundet me mbulue prej KEK-ut dhe është i detyruar me ble energji për me mbulue kërkesën për energji. Në të njëjtën kohë edhe Kostt-i dhe Keds-i, kanë për obligim me e ble energjinë elektrike për humbjet që janë të lejuara nga ZRRE.

Safete Hadërgjonaj - nëse krahasojmë me vitin 2016, sasia totale e importeve është rritur për 109 përqind më e lartë dhe çmimi i mesatares dhe importit është 29% më i lartë. Pse kanë këto rritje kaq të mëdha në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016? Si vendosni për buxhetin e Kostt-it dhe si ndikoni apo si e mbani nën kontroll Kostt-in për shpenzimin e buxhetit në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ju?

Petrit Pepaj - jeni në dijeni që gjatë nëntorit-dhejtor për problemet e energjisë elektrike për shkak të shpronësimit të zonave ku ka pas me u hap miniera dhe 50% e konsumit është mbuluar prej importit. ZRRE i përcakton të hyrat në bazë të kërkesës dhe arsyeshmërisë që i sjellin të licencuarit dhe në bazë të tyre përcaktohen tarifatat për shfrytëzimin e rrjetit të rrjetit të transmetimit. Tarifa përfshin kërkesën për ti mbuluar shpenzimet Kostt-i. Zakonisht bëhen përshtatjet në fund të vitit. Kostt-i ka obligim me raportu dhe obligimi ynë është me e mbikëqyrë atë. Ne monitorojmë punën e tyre, sigurohemi që të dhënat janë të sakta dhe këto të dhëna i pasqyrojmë në raportin që dorëzojmë në Kuvend. Këto të dhëna shfrytëzohen edhe prej organizatave ndërkombëtare.

Ejup Hasolli – theksoi se në Zyrën e Rregullatorit për Energji, përveç pagave dhe mëditjeve për udhëtimet jashtë vendit, shtesa tjera nuk ka. Nuk paguhen për mbledhjet e bordit. Paga dhe mëditjet janë një kategori ekonomike që emërohet ashtu, ndërsa mëditjet jashtë vendit janë kategori tjetër.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar të Zyrës Rregullative për Energji vitin 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku